



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 2733 Prot.

Tiranë më 15.10.2021

V E N D I M

Nr. 07, datë 01.10.2021

“Për disa shtesa në Rregulloren e Brendshme të Universitetit të Tiranës “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi COVID-19”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36, si dhe në Urdhrin nr. 413, datë 24.09.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit Covid-19 për personelin e Institucioneve Arsimore dhe Studentët”, i ndryshuar, në mbledhjen e datës 01.10.2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren e Brendshme të Universitetit të Tiranës “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi COVID-19”, të miratojë këto shtesa:

a) Në nenin 12, pas pikës 7, shtohet pika 8, si më poshtë:

8. Të gjitha njësitë përbërëse të UT-së, të identifikojnë personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ si dhe studentët që kanë depozituar Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit dhe të raportojnë elektronikisht pranë Rektoratit të UT-së, brenda datës 30 të çdo muaji. Rektorati i UT-së, paraqet pranë Institutit të Shëndetit Publik, informacion mujor mbi identifikimin e kryer.

b) Në nenin 18, pas pikës 1, të shtohen pika 1.1 dhe 1.2, si më poshtë:

1.1. Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021.

1.2. Përjashtim nga ky rregull, bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor, të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

c) Në nenin 19, pas pikës 1, shtohen pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3, si më poshtë:

1.1 Personeli akademik duhet të depozitojë pranë njësisë përkatëse, Certifikatën e Vaksinit Covid-19 nga e-albania apo kartën e vaksinit.

1.2 Në rast pamundësie, do të paraqesin, çdo fillim jave testin PCR "Negativ", të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve per efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2.

1.3 Përjashtim nga ky rregull, bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor, të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

d) Në nenin 20, pas pikës 1, shtohen pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3, si më poshtë:

1.1 Personeli ndihmës akademik dhe administrativ, duhet të depozitojnë pranë njësisë përkatëse, Certifikatën e Vaksinit Covid-19 nga e-albania apo kartën e vaksinit.

1.2 Në rast pamundësie, do të paraqesin, çdo fillim jave testin PCR "Negativ", të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve per efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2.

1.3 Përjashtim nga ky rregull, bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, pranë Rektoratit të UT-së.
3. Vendimi t'u përcillet të gjithë njësive kryesore për zbatim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha